

**RAPORT**

**VLERESIM PARAPRAK I NDIKIMIT NE**

**MJEDIS**

**I AKTIVITETIT TE PRODHIMIT TE ILAÇEVETE**

**DHE SUPLEMENTEVE USHQIMORE PER**

**NJEREZIT DHE KAFSHET**

**“LIFEMED”**

**XHAFZOTAJ, SHIJAK, DURRES**

**(VNM PARAPRAK I KERKUAR SIPAS VKM NR. 686,**

**DATË 29.7.2015)**



**ADMINISTRATOR: Z. GRIDI BOZDO**

**PERGATITUR NGA: “GREEN HOURS” SHPK**

**TIRANE, ME 26.10.2019**

<b>Permbajtja e lendes .....</b>	<b>2</b>
Hyrje .....	4
1. Informacion për qëllimin e VNM-së dhe metodikën e zbatuar.....	4
a. Përshkrim i qëllimit dhe objektivave të VNM-së.....	4
b. Përshkrim të përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin.....	5
1. Legjislacioni shqiptar ne fushen e mjedisit.....	5
2. Legjislacioni nderkombetar.....	7
c. Përshkrim të metodikës së zbatuar për hartimin e raportit paraprak te VNM-së.....	9
3. Përshkrimi i projektit, duke përfshirë:.....	9
a. Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi.....	9
b. Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij.....	17
c. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër.....	22
ç. Përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve.....	24
d. Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara.....	26
dh. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.....	27
..	

- e. Mundësia e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësia e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin.....27
- ë. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.....27

## **Hyrje**

Subjekti “LIFEMED” është në fazën e përgatitjes së dokumentacionit ligjor për marrjen e Lejes Mjedisore

Simbas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar aktiviteti i subjektit është, (i) prodhim i ilaçeve dhe suplementave ushqimore për njerëzit dhe kafshët, (ii) import dhe distribucion i ilaçeve dhe suplementeve ushqimore për njerëzit dhe kafshët, të produkteve kozmetike dhe të bukurisë dhe të mallrave të tjera konsumatore.

Gjatë periudhës Tetor 2019 me kërkesë të subjektit “LIFEMED” u realizua procesi i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedisë dhe aktivitetit të prodhimit të ilaçeve dhe suplementave ushqimore për njerëzit dhe kafshët.

Subjekti “LIFEMED”, ndërmjet të tjerave, synon të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Për këtë arsye, stafi drejtues është i impenjuar në procesin e realizimit dhe krijimit të kushteve për Vlerimin Paraprak të Ndikimit në Mjedisë dhe të përgatitjes së dokumentacionit të plotë për pajisjen me Leje Mjedisore.

Bazuar në legjislacionin për mjedisin, duke i referuar projektin të aktivitetit, studimeve paraprake mjedisore, etj, mendojmë që subjekti përmbush kriteret për realizimin e Studimit Paraprak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedisë.

## **1. Informacion për qëllimin e VNM-së dhe metodikën e zbatuar**

### **a) Përshkrim i qëllimit dhe objektivave të VNM-së**

Ky raport paraprak i vlerësimit të ndikimit në mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi për VNM-në dhe ka për qëllim të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar.

#### ***Objektivat afatshkurter të VNM-se janë:***

1. Përmirësim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar
2. Sigurimi që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet.
3. Sigurimi që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit
4. Sigurimi që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.
5. Mundësimi i informimit të vendim-marrësve, mbi aktivitetin dhe efektet në mjedis
6. Ndihma në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

**Objektivat afatgjate te VNM-se jane:**

1. Sigurimi dhe mbrojtja e shendetit te njeriut.
2. Parashikimi dhe parandalimi i ndryshimeve/demttimeve te pakthyeshme te mjedisit.
3. Ndikimi ne mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazheve te natyres dhe komponenteve perberes te ekosistemeve
4. Permiresimi i aspekteve sociale-ekonomike te projektit.

Zbatimi i VNM-se, duhet te perputhet me legjislacionin kombetar shqiptar dhe kerkesat europiane mjedisore e sociale-ekonomike.

**b) Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin;**

Per hartimin e studimit Vleresim Paraprak te Ndikimit ne Mjedis i aktivitetit te subjektit "LIFMED", me vendndodhje Xhafzotaj, Shijak, Durres, jemi mbeshtetur ne bazen ligjore te meposhteme:

**4. Legjislacioni shqiptar ne fushen e mjedisit**

**Ligji per Mbrojtjen e Mjedisit**

Parimet kryesore, te cilat rregullojne legjislacionin mjedisor ne Shqiperi, jane te njejta me ato te Bashkimit European. Ato jane te percaktuara ne ligjin per Mbrojtjen e Mjedisit nr. 10 431, date 9.6.2011, kapitulli II:

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershme te planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, permes harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit.

**Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis**

Ligji i VNM nr. 10440 dt. 07/07/2011 eshte nje nga aktet ligjore me te rendesishem per parandalimin e ndotjes apo demtimit te mjedisit nga aktivitet humane. Ky ligj kerkon berjen e nje vleresimi te pergjithshem, te integruar dhe ne kohe te ndikimeve mjedisore, te projekteve ose veprimtarive qe kerkojne te zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative ne mjedis.

**Ligji per Menaxhimin e integruar te Mbetjeve**

Ligji nr 10463, date 22.09.2011 ka per qellim te mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet:

- a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve;
- b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre;
- c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

Ky ligj përcakton rregullat e përgjithshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i tyre, përmes pakësimit të përdorimit të burimeve dhe përmirësimit të efikasitetit të këtij përdorimi.

### **Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore**

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse. Në nënë të vecanta të këtij ligji, Këshillat Bashkiake ushtrojnë të drejta dhe kompetencat e tyre të plota, ndër të tjera edhe për:

- planifikimin urban, menaxhimin e tokës dhe strehimit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- mbrojtjen e mjedisit;
- administrimin e parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbëra publike;
- grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbeturinave.
- furnizimin me ujë të pijshëm;
- funksionimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza dhe të kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara;
- funksionimin e transportit publik urban;
- ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore dhe historike vendore.

Krahas ligjeve të cituara më sipër, mbrojtja e mjedisit rregullohet dhe nga aktet ligjore të mëposhtme:

- “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”;
- “Për mbrojtjen e biodiversitetit”;
- “Për trajtimin e ujërave të ndotur”;
- “Për substancat dhe preparatet kimike”;
- “Për administrimin e zhurmave në mjedis”;
- “Për zonat e mbrojtura”;
- “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”;
- “Për taksën e karbonit dhe të ambalazhit plastik”;

Për zbatimin praktik të ligjeve të sipercituar janë në fuqi një sërë VKM dhe Udhezime, ndër të cilat nga më kryesoret janë:

- Vendimi “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”;

- Vendimi “Per normat e cilesise se ajrit”;
- Vendimi “Per normat e shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit”;
- Vendimi “Per shpalljen e monumenteve te natyres shqiptare”;
- Vendimi “Per administrimin e zonave te mbrojtura”;
- Vendimi “Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve”;
- Vendimi “Per Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- Vendimi “Per regullat dhe kriteret e menaxhimit te mbetjeve nga gomat e perdorura”;
- Vendimi “Per regullat dhe procedurat per asgjесimin e vajrave te perdorur”;
- Vendimi “Per baterite, akumulatorete dhe mbetjet e tyre”;
- Udhezimi “Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar Leje Mjedisore”.
- VKM nr 686 date 29.07.2015 “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore”
- VKM nr 660, date 31.10.2018 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve metalike
- VKM Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”

## **5. Legjislacioni nderkombetar**

- KONVENTA E BERNES “Per ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror ne Europe”. Ratifikuar me Ligjin Nr. 8294, date 02.03.1998;
- KONVENTA E BONIT “Per mbrojtjen e llojeve shtegetuесе te kafsheve te egra” dhe mirëkuptimet e saj . Ratifikuar me Ligjin Nr.8692, date 16.11.2000;
- KONVENTA E AARHUS : “Mbi te drejten e publikut per te pasur informacion ,per te marre pjese ne vendim-marrje dhe per t’iu drejtuar gjykatesper ceshtjet e mjedisit”. Ratifikuar me Ligjin Nr.8672, date 26.10.2000;
- KONVENTA KUADER E KOMBEVE TE BASHKUARA PER NDRYSHIMET KLIMATIKE, Tetor 1994;
- KONVENTA E KOMBEVE TE BASHKUARA PER BIODIVERSITETIN, Janar 1994;

### **c) Përshkrim të metodikës së zbatuar për hartimin e raportit paraprak të VNM-së:**

#### **-Autorët e hartimit të Raportit Paraprak të VNM-së;**

Studimi per hartimin e Raportit Paraprak te VNM-se te aktivitetit te subjektit “LIFEMED” eshte realizuar nga Studio e Konsulences “Green Hours” shpk

Studio e konsulences “Green Hours” shpk eshte studio e paisur me Licence LN-7408-02-2014 per hartimin e raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis, per te kryer auditim mjedisor, per hartimin e ekspertizave per probleme mjedisore dhe thirjen si ekspert per te vleresuar nje raport te vleresimit te ndikimit ne mjedis ose rezultatet e nje auditimi.

“Green Hours” shpk eshte e certifikuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave sipas Vendimit Nr 3, Nr 197 regjistri, Nr 324 prot, date 20.04.2006.

Prane studios “Green Hours” shpk punon si drejtues teknik eksperti mjedisor Denis Harasani i paisur me Certificate nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave me Nr 5116 Prot, Nr identifikues 143, date 08.07.2013.

“Green Hours” shpk eshte e regjistruar ne QKR dhe eshte e paisur me NIPT K61626009I

Gjate periudhes Tetor 2019 me kerkese te administratorit te subjektit u realizua procesi i Vleresimit Paraprak te Ndikimit ne Mjedis i aktivitetit i aktivitetit te prodhimit te ilaceve dhe suplementave ushqimore per njerezit dhe kafshet.

Bazuar ne ligjin Nr 10440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”, Shtojca II, pika 6B, duke i u referuar gjendjes aktuale te nderteses, ambjenteve te jashteme dhe infrastruktures, etj, mendojme qe subjekti permbush kriteret per realizimin e Studimit Paraprak te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

**- Metodikat e zbatuara dhe mënyra e sigurimit të informacionit për hartimin e raportit paraprak të VNM-së (nëse është e detajuar mund të vihet edhe si shtojcë e raportit);**

Procesi i Vleresimit te thelluar te Ndikimit ne Mjedis u realizua sipas hapave te me poshteme:

- Njohja me subjektin qe ushtron aktivitetin
- Njohja me objektin ku zhvillohet aktiviteti
- Njohja me problematiken e pergjitheshme dhe natyren e aktivitetit
- Njohje me linjat kryesore teknologjike.
- Njohje me produktin
- Identifikimi i lendeve te para.
- Identifikimi i lendeve ndihmese te perdorura ne procesin e ndertimit dhe shfrytezimit
- Identifikimi i mbetjeve dhe shkarkimeve te ndara sipas natyres
  - Mbetje te ngurta
  - Shkarkime ne ajer
  - Shkarkime ne uje
- Njohje me masat e mara per trajtimin e mbetjeve
- Identifikimi i mundesive per minimizimin e ndikimit

Rezultatet e ketij vleresimi paraqiten ne kete raport me qellimin final:



- Vleresimin e bilancit te shkarkimeve ne ajer.
- Identifikimin e shkarkimeve ne ujrak siperfaqesore dhe nentokesore
- Trajtimin mjedisor te mbetjeve te ngurta
- Hartimin e programit te monitorimit
- Perfundime.

**- Konsultimet e realizuara gjate hartimit te raportit te thelluar te VNM-se;**

Eksperti eshte konsultuar me:

**Legjislacioni**

Ligji per Mbrojtjen e Mjedisit nr. 10 431, date 9.6.2011, kapitulli II

Ligji i VNM nr. 10440 dt. 07/07/2011

VKM nr 686 date **29.07.2015** per VNM

**Burime nga interneti**

**Studime te botuara**

Plani i Pergjithshem Vendor, Bashkia Shijak

Raport per gjendjen e mjedisit 2017, 2018 (AKM)

Modele te VNM-ve te miratuara nga AKM

**- Nje pershkrim te veshtiresive (mangesive teknike ose te njohurive) qe zhvilluesi ka hasur gjate hartimit te informacionit te kerkuar.**

Gjate hartimit te VNM, nuk ka patur veshtiresi, perkundrazi, stafi drejtues ishte i impenjuar ne procesin e realizimit dhe krijimit te kushteve per Vlersimin Paraprak te Ndikimit ne Mjedis dhe te pergatitjes se dokumentacionit te plote per paisjen me Leje Mjedisore

**2. Pershkrimi i projektit, duke perfshire:**

- a. Pershkrimi i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi;**

Aktiviteti qe vleresohet zhvillohet ne nje siperfaqe 4990 m<sup>2</sup> dhe nje ndertese me siperfaqe 3000m<sup>2</sup>, ndodhur ne fshatin Xhafzotaj, Njesia administrative Xhafzotaj, Bashkija Shijak, Qarku Durres. Aktiviteti eshte ekzistues.

**Bimesia e kultivuar** qe karakterizon kete zone perbehet kryesisht nga kulturat bujqesore si dritherat, foragjeret, perimet, pemet frutore, ulliri etj. Kjo zone, perpara viteve 90 ka qene me destinacion bujqesor e blegtoral. Edhe ne ditet e sotme, megjithese simbas Planit te Zhvillimit kjo zone eshte projektuar per zhvillimin industrial dhe materjaleve te ndertimit, ne pjese te vecanta zhvillohet aktivitet bujqesor

## **Biodiversiteti**

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut vazhdojnë të ruajnë shumëllojshmëri dhe sasi të konsiderueshme të biodiversitetit. Këto territore bëjnë pjesë në zonën biogeografike mesdhetare dhe shquhen për diversitet të lartë të ekosistemeve detare, bregdetare, lagunore, kënetore, lumore, të shkurretave mesdhetare përherë të gjelbërta dhe gjetherënëse dhe dushqeve.

Megjithatë, grupe të shumta bimore dhe shtazore janë ende të panjohura e të pastudiara. Mungesa e njohurive shkencore rreth potencialit dhe vlerave të botës bimore dhe shtazore ka bërë që në vazhdimësi kjo pasuri të mos vlerësohet ekonomikisht, çka do të sillte rritje të të ardhura tek banorët vendas.

Sipas Konventës së Biodiversitetit (1994): “Pasuritë gjenetike, organizmat, popullimet apo çdo komponent tjetër biotik me potenciale aktuale të vlerës dhe përdorim të njeriut konsiderohen resurse biologjike”. Territoret e të dyja bashkive kanë bimësi të katit të shkurreve mesdhetare ( përherë të gjelbërta e gjetherënëse), bimësi të katit të dushqeve dhe përfaqësues të katit të ahut pavarësisht lartësisë së vogël mbi nivelin e detit.

Në këto territore gjendet edhe një pasuri e madhe shtazore, si tokësore dhe ujore. Bota shtazore tokësore ka si habitat hapësirat e pasura me botë bimore, ndërsa bota shtazore ujore gjendet si në Ujërat e kripura të detit Adriatik, lagunave bregdetare, por edhe në Ujërat e ëmbla të lumenjve Erzen dhe Ishëm. Në vazhdim do të trajtohet i gjithë potenciali i biodiversitetit në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut.

## **Pasuria bimore (Flora)**

Pasuria bimore tokësore

Burimet pyjore janë të gjithë elementet natyrore të një sipërfaqeje pylli a toke pyjore, me vlerë të konsiderueshme, të përdorshme për nevojat e njeriut.

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut bëjnë pjesë në katin fito-klimatik të shkurreve mesdhetare (makje-shibjaku) dhe të dushqeve. Fizionomia e bimësisë së kësaj zonë karakterizohet kryesisht nga shkurre gjithmonë të blerta dhe pjesërisht nga shkurre që i lëshojnë gjethet gjatë stinës së dimrit.

Nga shkurret me gjethë gjithmonë të blerta, që bëjnë pjesë në ndërtimin e makjes, më karakteristike janë: mareja ( *Arbutus unedo* L.) mërsina ( *Myrtus communis* L), xina ( *Pistacia*

lentiscus L), shqopa ( Erica arborea L.), gjëneshta (Spartium junceum L.), dafina e egër ( Laurus nobilis) etj.

Nënkati i shibjakut përfaqësohet nga bungëbuta ( Quercus pubescens), shkoza e zezë (Carpinus orientalis) dhe frashëri i bardhë ( Fraxinus ornus L.)

Në këto territore gjenden formacione të vogla natyrore të pyjeve të lagura ( higrofile). Ato janë të përhapura në grykëderdhjen e lumenjve Erzen dhe Ishëm, në tokat aluvionale dhe në tokat bregdetare me nivel të lartë të ujërave nëntokësore. Përgjatë rrjedhjes së poshtme të Erzenit dhe Ishmit gjenden formacione me Vidha ( Alnus glutinosa), Rrape ( Platanus orientalis), Shelg të bardhë ( Salix alba), Shelg të kuq ( Salix purpurea) dhe Plepa të bardhë (Populus alba)

Në zonën e Rrushkull-Hamallajt gjendet një brez i ngushtë i pyjeve halorë mesdhetare me specie dominante: Pishë bregdetare (Pinus pinaster),Pishë e egër (Pinus halepensis) dhe rrallëherë Pishë e butë (Pinus pinea), e kultivuar 40 – 50 vjet më parë për stabilizimin e dunave ranore dhe mbrojtjen e tokave bujqësore

Si shoqërues i katit shkurror dhe pyjor është mbulesa bimore, kryesisht e tipit umbrofil. Shoqërimet kryesore bimore të zonës janë: Fieri ( Petris aquiliana), Lisna ose Timusi ( Thymus vulgaris), Shelgu i Bardhë (Salix alba L.), Telishi ( Dactylis glomerata), Vicia ( Vicia Dasycarpa), Menishtet ( Cistus salvifolius), Festuca ( Festuca varia), Teukli ( Teocrium polium), Bocka ( Urginea maritima bok), Tërfili ( Trifolium pratense), Shpendra ( helleborus edours), Lule shqerra( Bellis perennis), Geranium ( Geranium pyrenacium), Barbstari ( Sanguisorba officina), Ban i bletës ( Meishema officinalis), Hedera ( Hedera helix), Qumështorja ( Euphorbia cuparisias), Hithra ( Urtica dioica) Mellaga ( Althaea officinalis) etj.

Në këto territore rritet bimë mjekësore dhe aromatike si: Mimoza ( Acacia dealbata), Petriku kulper ( Aristolochia clematitis), Pelini i Zi ( Artemisa vulgaris), Minuri si pelin deti ( Chenopodium ambrisioidos), Menishtja me push ( Cistus incanus), Ekualipti rruazor ( Ecualeptus glopulus), Dëllinja e kuqe ( Juniperus oxycedrus), Fidhësi ( Juniperus communis), Dafina ( Laurus nobilis), Mëllaga ( Malva silvestris), Rigoni i Bardhë ( Origanum vulgare), Lulëkuqja ( Papaver rhoeas), Majdanoz ( Petroselinum sativum), Pisha e butë ( Pinus pinea), Trumza ( Saturea montana), Bar majasëlli ( Teocrium polium), Matriku ( Vinca major) dhe Konopica ( Vitex agnus-castus).

Statusi i mbrojtjes.

Sipas Librit të Kuq, në hapësirën territoriale të këtyre bashkive gjenden:

- Bimë që mund të zhduken (Ex) si:

Rrënja (*Quercus robur*) e familjes Fagaceae-Ahore. Rrënja është një lloj druri rreth 30-40 m e lartë, me lëvore të murrme të errët. Konsiderohet si gjetherënëse dhe lulëzon në prill-maj. Gjendet kryesisht në pyet aluviale në fushën e Hamallës dhe të Rrushkullit

- Bimë të rrezikuara (E), ku bëjnë pjesë:

Rodhëza (*Agrimonia eupatoria*) e familjes Rosaceae-Trëndafilore, Dishël, bar uzo, lule mastike (*Distamnus albus*) e familjes Rutaceae-Ruzore, Pleçgjaje, luletogëz (*Digitalis lanata*) e familjes Scrophulariaceae-Sarushtore, Gjunjëza (*Ephedra distachya*) e familjes Ephedraceae-Gjunjëzore, Mëtergonë, bar i trashë (*Hyosciamus niger*) e familjes Solanaceae-Hikërore, Lulebasani, balç, lulegjaku, lulemaji (*Hypericum perforatum*) e familjes Guttiferae-Gutifere, Dëllinja e zezë (*Juniperus communis*) e familjes Cupressaceae-Selviore, Dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus*) e familjes Cupressaceae-Selviore, është shkurre deri 4-5 m e lartë. Degët i ka të hapura dhe me hala treshe, gjëmbore. Dafina (*Laurus nobilis*) e familjes Lauraceae-Dafinore, Pllatkë trimajëshe (*Matthiola tricuspidata*) e familjes Cruciferae-Kryqore, Zambaku i detit (*Pancratium maritimum*) i familjes Amaryllidaceae-Amarilidore, Dorëvatë (*Sarcopoterium spinosum*) e familjes Rosaceae-Trëndafilore.

- Në kategorinë e bimëve të prekshme (V) bëjnë pjesë:

Biliqin (*Butomus umbellatus*) e familjes Butomaceae-Bliqinore, Kladi marisk (*Cladium mariscus*) e familjes Cyperaceae-Cyperore.

- Ndërsa në Bimët e ralla (R) bën pjesë:

Aster shqiptar (*Aster albanicus*) e familjes Compositea-kompozite, është bimë barishtore deri 30 cm e lartë dhe ka lule gjuhëzore ngjyrë manushaqe. Gjendet në ranishtet bregdetare me shumë lagështirë të Durrësit. Mund të përdoret si bimë zbukuruese.

Sipas të dhënave zyrtare, për vitin 2016, të territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden 9 263.61 ha ose rreth 92.7 km<sup>2</sup> bimësi natyrore. Në bashkinë e Durrësit gjenden 8 772.16 ha tokë me bimësi natyrore, nga të cilat 5 494.55 ha janë të zëna me pyje, 1 983.9 ha të zëna nga shkurret mesdhetare (makje dhe shibjak), 692.41 ha janë kullota, 54.19 ha bimësi ujore, 20.85 ha bimësi pyjore dhe 4.3 ha pyll gështenje.

Bashkia e Shijakut, që ka një sipërfaqe më të vogël, ka rreth 491.45 ha tokë me bimësi natyrore, nga të cilat 295.74 ha janë të zëna me pyje, 143.26 ha të zëna nga shkurret mesdhetare (makje dhe shibjak), 31.7 ha janë kullota dhe 17.5 ha bimësi pyjore.

Ne afersi të vend pozicionimit të subjektit LIFEMED nuk ka zona të mbrojtura ose pjesë të tyre simbas percaktimit të bere nga AKZM (Zona reptesisht të mbrojtura, Parqe kombetare, Monumente natyrore, Zona të menazhuara, Peisazhe të mbrojtura tokësore-detare dhe Zona të mbrojtura burimesh)

Lista e zonave te mbrojtura te Shqiperise

<b>ID</b>	<b>Emri Përshkrimi</b>	<b>Tipi</b>	<b>Vendndodhja Përdoruesi Sipërfaqja, ha</b>	<b>Koordinatat</b>	
19	<b>GjeoMonumente Nr.</b> (VKM nr.676,date 20.12.2002)	III	. 0.0 ha		
17	<b>Mali i Tomorrit</b> (VKM nr.432,date 18.07.2012)	II	Berat, Skrapar, Gramsh. 24.723.1 ha		
32	<b>Balloll</b> (Rreg.MB nr. 1, date 27.7.1977)	IV	Berat. 330.0 ha		
35	<b>Rrezome</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)	IV	Delvine. 1.400.0 ha		
22	<b>Syri i Kaltër</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)	III	Delvine. 180.0 ha		
25	<b>Cangonj</b> (Rreg.MB nr. 1, date 27.7.1977)	IV	Devoll. 250.0 ha		
48	<b>Nikolice</b> (VKM nr. 102, date 15.01.1996)	V	Devoll. 510.0 ha		
45	<b>Korab-Koritnik</b> (VKM nr.898,date 21.12.2011)	IV	Diber, Kukes. 55.550.2 ha		
4	<b>Parku Kombëtar i Lurës</b> (VKM nr. 96,date 21.11.1966)	II	Diber. 1.280.0 ha		
53	<b>Luzni-Buiac</b> (VKM nr. 102, date 15.01.1996)	VI	Diber. 5.900.0 ha		
23	<b>Vlashaj</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)	III	Diber. 50.0 ha		
34	<b>Rrushkull</b> (Urdher MB nr.2,date 26.12.1995)	IV	Durres. 650.0 ha		
33	<b>Qafe Bushi</b> (Rreg.MB nr. 1, date 27.7.1977)	IV	Elbasan. 500.0 ha		
29	<b>Pishe Poro</b> (Rreg.MB nr. 1, date 27.7.1977)	IV	Fier. 1.500.0 ha		

<b>ID</b>	<b>Emri Përshkrimi</b>	<b>Tipi</b>	<b>Vendndodhja Përdoruesi Sipërfaqja, ha</b>	<b>Koordinatat</b>	
31	<b>Levan</b> (Rreg.MB nr. 1, date 27.7.1977)	IV	Fier. 200.0 ha		
21	<b>Zhej</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)		Gjirokaster. 1.500.0 ha		
20	<b>Bredhi i Sotirës</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)	III	Gjirokaster. 1.740.0 ha		
2	<b>Rezervati natyror "Kardhiq"</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)	I	Gjirokaster. 1.800.0 ha		
36	<b>Tej Drini Bardhe</b> (VKM nr. 102,date 15.01.1996)	IV	Has. 30.0 ha		
37	<b>Germenj-Shelegur</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)	IV	Kolonje. 430.0 ha		
54	<b>Piskai-Shqeri</b> (VKM nr. 102, date 15.01.1996)	VI	Kolonje. 5.400.0 ha		
ramsar-4	<b>Liqeni i Prespave</b> (VKM nr. 489, dt. 13.06.2013)	RAMSAR	Korce, Devoll. 15.118.6 ha		
27	<b>Krastafillak</b> (Rreg.MB nr. 1, date 27.7.1977)	IV	Korge. 250.0 ha		
6	<b>Parku kombëtar Bredhi i Drenovës</b> (VKM nr. 96,date 21.11.1966)	II	Korçe. 1.380.0 ha		
10	<b>Parku Kombëtar i Prespës</b> (VKM nr. 80,date 18.02.1999)	II	Korçe. 27.750.0 ha		
8	<b>Parku Kombëtar i Qafë Shtamës</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)	II	Kruje. 2.000.0 ha		
44	<b>Patok-Fushekuqe-Ishem</b> (VKM nr. 995, date 03.11.2010)	IV	Kurbin. 5.000.7 ha		
43	<b>Kune-Vain-Tale</b> (VKM nr.432, date 28.04.2010)	IV	Lezhe. 4.393.2 ha		

ID	Emri Përshkrimi	Tipi	Vendndodhja Përdoruesi Sipërfaqja, ha	Koordinatat
30	<b>Berzane</b> (Rreg.MB nr. 1, date 27.7.1977)	IV	Lezhe. 880.0 ha	
14	<b>Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë</b> (VKM nr. 640, date 21.05.2008)	II	Librazhd, Bulqize. 33.927.7 ha	 41°13'21.51" Veri 20°27'00.07" Lindje
28	<b>Kuturman</b> (Rreg.MB nr. 1, date 27.7.1977)	IV	Librazhd. 3.600.0 ha	
40	<b>Sopot</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)	IV	Librazhd. 300.0 ha	
39	<b>Stravaj</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)	IV	Librazhd. 400.0 ha	
41	<b>Dardhe-Xhyre</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)	IV	Librazhd. 400.0 ha	
38	<b>Polis</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)	IV	Librazhd. 45.0 ha	
13	<b>Parku Kombëtar Divjakë - Karavasta</b> (VKM nr. 687, date 19.10.2007)	II	Lushnje,Fier, Kavaje. 22.230.2 ha	
ramsar-1	<b>Laguna Karavastase Pisha Divjakes</b> (VKM nr.413,date 22.08.1994)	RAMSAR	Lushnje,Fier. 20.000.0 ha	
9	<b>Parku Kombëtar Zall Gjoçaj</b> (VKM nr.102,date 15.01.1996)	II	Mat. 140.0 ha	
46	<b>Liqeni i Ulzez dhe zona perreth tij</b> (VKQ nr. 16, date 03.04.2013)	IV/1	Mat. 4.206.0 ha	
55	<b>Bjeshka e Oroshit</b> (VKM nr. 102, date 15.01.1996)	VI	Mirdite. 4.745.0 ha	
15	<b>Bredhi i Hotoves-Dangelli</b> (VKM nr. 1631,date 17.12.2008)	II	Permet, Kolonje, Vlorë. 34.361.1 ha	
56	<b>Guri i Nikes</b> (VKM nr. 102, date 15.01.1996)	VI	Pogradec.	

ID	Emri Përshkrimi	Tipi	Vendndodhja Përdoruesi Sipërfaqja, ha	Koordinatat
			2.200.0 ha	
49	<b>Pogradec</b> (VKM nr. 80, date 18.02.1999)	V	Pogradec. 27.323.0 ha	
ramsar-2	<b>Kanaii Qukes-Butrint-Keçi Stillos</b> (VKM nr.531, date 31.10.2002)	RAMSAR	Sarande. 13.500.0 ha	
11	<b>Parku Kombëtar i Butrintit</b> (VKM nr. 134, date 20.02.2013)	II	Sarande. 9.424.4 ha	
51	<b>Lumi Buna-Veëipoje</b> (VKM nr. 682, date 02.11.2005)	V	Shkoder. 23.027.0 ha	
42	<b>Liçeni i Shkodres</b> (VKM nr. 684, date 02.11.2005)	IV	Shkoder. 26.535.0 ha	
ramsar-3	<b>Liçeni Shkodres-Lumi Bunes</b> (VKM nr. 683, date 02.11.2005)	RAMSAR	Shkoder. 49.562.0 ha	
3	<b>Thethi</b> (VKM nr. 96, date 21.11.1966)		Shkodër. 2.630.0 ha	
18	<b>BioMonumente Nr.</b> (VKM nr. 676, date 20.12.2002)	III	Shqipëri. 0.0 ha	
26	<b>Bogove</b> (Rreg.MB nr. 1, date 27.7.1977)	IV	Skrapar. 330.0 ha	
12	<b>Mali i Dajtit</b> (VKM nr. 402, date 21.06.2006)	II	Tirane, Krujë. 29.216.9 ha	 41°23'04.02" Veri 19°55'27.02" Lindje
52	<b>M. Gropa-Bize-Martanesh</b> (VKM nr.49, date 31.01.2007)	V	Tirane, Mat, Buiqize. 25.266.4 ha	
47	<b>Nikaj Mertur</b> (VKQ nr. 32, date 13.10.2014)	IV/1	Tropoje. 17.505 ha	
1	<b>Lumi i Gashit</b> (VKM nr.102, date 15.01.1996)	I	Tropoje. 3.000.0 ha	 42°22'36.98" Veri 20°05'45.99" Lindje
7	<b>Lugina e Valbonës</b> (VKM	II	Tropoje. 8.000.0 ha	



ID	Emri Përshkrimi	Tipi	Vendndodhja Përdoruesi Sipërfaqja, ha	Koordinatat	
	nr.102,date 15.01.1996)				
5	<b>Parku Kombëtar i Llogarasë</b> (VKM nr. 96,date 21.11.1966)	II	Vlore. 1.010.0 ha		
16	<b>PKD Karaburun-Sazan</b> (VKM nr.289, date 28.04.2010)	II	Vlore. 12.428.0 ha		
50	<b>Vjose-Narte</b> (VKM nr. 680, date 22.10.2004)	V	Vlore. 19.738.0 ha		
24	<b>Karaburun</b> (Rreg.MB nr. 1, date 27.7.1977)	IV	Vlore. 20.000.0 ha		

**b. Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;**

**Lumi Erzen**

Rrjeti hidrografik me ujra mbitokesore eshte shume i pasur. Zona eshte ne formen e nje lugine te formuar kryesisht nga gerryerjet dhe me pas depozitimet e lumenjve. Rreshjet jane ushqimi ujqor i rrjedhjes sipërfaqesore te pellgjeve ujembledhes, si dhe burim per akumulimin e ujerave nentokesore. Pervec lumit Erzen, ne territorin e bashkise ndodhen liqene dhe perrenj, te cilet e pasurojne me shume rrjetin hidrografik.

Lumi Erzeni perfaqeson nje nder lumente e rendesishem qe pershkojne pjesen qendrore te vendit. Pellgu i lumit Erzen me sipërfaqe te pellgut ujembledhes 760 km<sup>2</sup>, zhvillohet ne zonen malore ne lindje dhe juglindje te Tiranës dhe ka nje lartesi mesatre 435 m mbi nivelin e detit. Erzeni buron ne afërsi te qafes se Gurakuqit, ne kuton 1300 m mbi nivelin e detit dhe ka gjatesi te pergjithshme 109 km dhe prurje mesatre vjetore 18.1 m/s me nje modul te prurjes prej 24 l/s/km<sup>2</sup>.

Koeficienti i rrjedhjes ujore vjetore per te gjithë pellgun e Erzenit eshte a= 051. Si pasoje e ndertimit gjeologjik te pellgut te tij ujembledhes, formacione te papershkueshme ne 60% te sipërfaqes, gjysem te pershkueshme ne 5 % te saj dhe 35 % e mbetur nga formacione te papershkueshme, ushqimi nentokesor perfaqeson 31 % te rrjedhjes vjetore, ndersa ai sipërfaqesor 69 % te saj. Ujrat e lumit jane perdorur dhe perdoren kryesisht per vaditje dhe shume pak per uje te pijshem (pas depurifikimit) Pergjate lugines se tij ka shum puse te ceket uji qe perdoren per furnizimin me uje ne zonat rurale

Lumi Erzen eshte lumi me i gjate ne rajonin lumor “Ishem – Erzen”, me nje gjatesi prej rreth 109 km ne total. Kalon ne pjesen lindore e jug-lindore te Bashkise Shijak. Gjate rjedhes formon lugina te thella, sidomos ne pjeset e sipërme te rrjedhjes se tij.

Prurja mesatare shumevjecare ne Sallmonaj arrin ne 18 m/sek. Prurja e inerteve 101 kg/sek. Lumi i Erzenit gjate rrjedhes se tij merr me vete nje sere perrenjsh qe derdhen ne shtratin e tij duke filluar nga zona e Shengjergjit e Qaf Molles, e duke vazhduar ne veri te Krrabes, ne zonen e Mulletit, Farkes, Fortuzajt, Arbanes, duke vazhduar drejt Pezes se Vogel, Ndroqit e Shijakut, pershkon neper Ultesiren e Erzenit ne veri te qytetit te Durrës dhe derdhet ne detin Adriatik ne gjirin e Lalzit.

Gjate rruges se tij te gjate, lumi Erzeni nderpret depozitime nga me te ndryshmet, si shkembinj efuzive te zones se Shengjergjit, shkembinj karbonatike te vargmalit te Dajtit dhe shkembinj ranore e argjilore ne vazhdim te rrjedhjes se tij. Ne keto pjese, shtrati i lumit eshte me i gjere dhe ka me shume materiale inerte se ne pjeset e tjera. Uji i lumit Erzen ka rrjedhje te shpejte e prurje te madhe dhe ne kohen e reshjeve shtohen shume prurjet e ujit, sa qe shpesh ky lume behet i rrezikshem per zonat e banuara dhe tokat bujqesore, duke shkaktuar permbytje dhe erozion te tokave bujqesore. Ne te dy anet e lumit jane formuar terraca te vjetra lumore. Ne zonen e Pellumbasit dhe grykes se Skoranes, ku lumi Erzen nderpret shkembinjte karbonatike te Kretakut dhe Paleogjenit, formon nje lugine te thelle e te ngushte me kanione shume te bukur, nje lugine piktoreske dhe me vlera turistike, vlera te cilat shtohen dhe nga prania ne kete zone e shpelles shume te bukur karstike te Pellumbasit, me gjatesi rreth 300 m, gjeresi 4 - 6 - 10m, lartesi 2 - 3 - 4 m., vende - vende 6 - 8 - 10m. Bukuria e kesaj zone shtohet dhe nga diga e ujembledhesit te Skoranes dhe burimi karstik i Pellumbasit qe ndodhet ne lugine, ne veri te fshatit Pellumbas. Te gjitha keto, formojne nje kompleks me vlera gjeoturistike ne afersi te Tiranës.

Ujërat e Erzenit kanë një mineralizim mesatar prej  $mi = 354 \text{ mg / lit}$  dhe një fortësi prej 10,7 gradë gjermane. Vlerat e oksideve të tretura në ujë paraqiten në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 23. Treguesit cilësorë të Ujit të lumit Erzen**

Emërtimi	O <sub>2</sub> itretur	NKO (KMNO <sub>4</sub> )	NBO	NH <sub>4</sub> mg/l	NO <sub>2</sub> mg/l	NO <sub>3</sub> mg/l	SiO <sub>2</sub> mg/l	P <sub>2</sub> O <sub>5</sub> mg/l	P total mg/l
L.Erzen	7.95	1.72	0.90	0.04	0.008	0.35	11.0	0.01	0.015

*Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar. Atlasi klimatik i Shqipërisë, Tiranë 1988*

Temperatura mesatare mujore e ujërave të këtij lumi lëkundet nga 6,4 °C në janar deri në 29 °C në gusht.

Ky lumë kalon në hapësirat e disa qendrave rurale dhe urbane. Lumi Erzen kalon në territoret e bashkisë Shijak konkretisht në fshatrat Çismeli, Hardhishtë, Pjezë, Rreth, në qytetin e Shijakut dhe fshatin Salmone. Pikërisht në Salmone del nga kjo bashki dhe kalon në territoret e bashkisë Durrës.

### Ujëmbledhësit artificialë

Bashkia e Durrësit dhe e Shijakut kanë një numër të madh ujëmbledhësish (rezervuarësh artificialë), rreth 35 të tillë. Sipas Zyrës së Bordit të Kullimit Durrës, në hapësirën territoriale të

Bashkise Durres gjenden 20 ujëmbledhësa, ndërsa në territoret e bashkisë Shijak gjenden 15 të tillë.


Në bashkinë Shijak gjenden ujëmbledhësat Shijak (në njësinë administrative Shijak); Karpen, Rubjekë, Bilalas, Kareç (në njësinë administrative Maminas); Likesh, Çallik, Romanat, Cismeli, Gjepalaj, Shtrazë, Shetel, Lagjia Popullore (në njësinë administrative Gjepalaj); dhe Koxhaz e Pjezë (në njësinë administrative Xhafzotaj).

Të gjithë ujëmbledhësat e rrethit Durres zënë një sipërfaqe totale prej 6 368 ha dhe kanë kapacitet ujëmbajtës të projektuar prej 55 768 000 m<sup>3</sup> ujë.

### Ujrat nentokesor

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut bëjnë pjesë në sistemin ujëmbajtës të kuaternarit. Këto ujra gjenden shumë pranë sipërfaqes së tokës për shkak edhe të lartësisë së vogël mbi nivelin e detit. Furnizuesi kryesor i ujërave nentokësore është uji sipërfaqësor i lumit Erzen.

Përbërja kimike e ujërave nentokësore është e ndryshme të këtë hapësirë territoriale. Në pjesën perëndimore të fushës së Durrësit uji ka mineralizim të tipit klorur natriumi, kurse në lindje mineralizim të tipit bikarbonat-kalcium-magnez. Ujërat nentokësore janë përdorur në vazhdimësi për ujitje dhe përdorim familjar sidomos në hapësirat territoriale ku mori zhvillim informaliteti dhe ku mungon furnizimi me ujë të pijshëm.



## Baseni Ishem-Erzen

### Monitorimi i ujrave

Treguesit që monitorohen:

- Për stacionet lumore: temperatura, pH, alkalinitet, saliniteti, përcjellshmeria elektrike, oksigjeni i tretur, NKO, NBO5, nitritet, nitratet, amoniaku, Ptotal, PO4, lënda pezull

Përgjate vitit 2016 monitorimi ka qenë i pjesshëm për efekt të mungesës së buxhetit dhe për Basenin e Drinit është realizuar një ekspeditë, Lumi Ishëm 3 ekspedita, Lumi Erzen 2 ekspedita, Baseni Shkumbinit 1 ekspeditë, Baseni i Semanit 1 ekspeditë, Baseni i Vjosës 1 ekspeditë, Baseni i Matit 1 ekspeditë.

Klasifikimi i cilësisë së ujërave është kryer bazuar në vlerat limite të Direktives Kuader te Ujit. Sipas kësaj Direktive, ujërat e lumenjve klasifikohen në pesë klasa, ku gjëndja e moderuar ose klasa e tretë, konsiderohet si klasa me nivelin minimal të pranueshëm të cilësisë së ujërave të lumenjve. (Tabelat janë paraqitur ne Aneks)


Ne grafiket e mëposhtem jepen vlerat e disa treguesve të matur sipas stacioneve lumore. Me inicialin Er2 janë rezultatet e dy matjeve në lumin Erzen

### Parametrat e analizuar në laborator

#### Nevoja Biokimike për oksigjen.

Nevoja Biokimike për oksigjen është sasia e oksigjenit të tretur që nevojitet të konsumohet nga organizmat biologjike aerobike të cilat ndodhen në sasinë e kampionit në shishen e pajisur me oxitop. Ky parametër është i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve, tregues i shkallës së ndotjes.


Per lumin Erzen ky tregues është nën vlerat kufi



## Nevoja kimike për oksigjen

Nevoja kimike për oksigjen është tregues i ndotjes organike dhe kimike, ku të dhënat e monitorimit janë paraqitur në grafikun si vijon.


PËRMBAJTJA E NEVOJËS KIMIKE PËR OKSIGJEN



## Përmbajtja e a Amonjakut

Përcaktimi i përmbajtjes së amoniakut në kampione uji i përcaktuar me metoden spektrometrike është parametër kryesor i klasifikimit në klasa të cilësisë së ujërave sipas DKU.


PERMBAJTJE E AMONJAKUT



## Permbajtja e Nitriteve


Sic vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm, përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar.

## PERMBAJTJE E NITRITEVE



**Permbajtja e Nitrateve** ne te gjitha stacionet e monitoruara rezulton ne vlera me te uleta se norma e lejuar.


## PERMBAJTJE E NITRATEVE



## Permbajtja e Fosforit Total

Permbajtja e fosforit total per ekspediten e kryer gjate vitit 2018 paraqitet ne grafikun e meposhtem. Per lumin Erzen ky tregues eshte nen vlerat kufi

## PERMBAJTJE E FOSTORIT TOTAL



Pika e marjes se mostrave te ujit te Lumit Erzen me e afert me subjektin qe vleresohet eshte Pika e Sallmones. Treguesit e monitoruar per kete pike dhe klasifikimi simbas DKU eshte si me poshte

Treguesi	Klasifikimi	Vlera	Norma
O <sub>2</sub> i tretur	I	7.2	> 7
NBO <sub>5</sub>	III	6	< 7
NH <sub>4</sub>	II	0.25	< 0.3
NO <sub>2</sub>	II	0.05	< 0.06
NO <sub>3</sub>	I	0.6	< 0.8
P-Total	I	0.09	< 0.1

Shenim. Per vitin 2016 nuk jane kryer analiza te ujrave te ujembledhesve dhe te ujrave freatike ne zonen ne afersi te subjektit qe vleresohet.

**c. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;**

**Vleresim i impakteve kryesore ne mjedis**

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit.

Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut:

Sa me siper vleresimi i ndikimeve ne mjedis do te vleresoje:

Ndikimet ne ajer  
 Ndikimet ne ujera  
 Ndikimet ne toke  
 Ndikimet ne biodiversitet (mjedisi biologjik)  
 Ndikimet ne mjedisin social-ekonomik  
 Ndikimet qe shkaktojne ndryshimet klimatike

Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit

### **Shkarkime ne uje**

Ky aktivitet nuk perdor uje ne proceset e punes. Shkarkime te ujrave te perdorur mund te permendim vetem ujrat higjenosanitare te ambjenteve te tualeteve. Keto ujra shkarkohen ne grope seprike dekantuese.

Shkarkime kemi edhe nga ujrat e larjes se ambjenteve dhe ujrave te shirave te cilat nepermjet pusetave dekantuese derdhen ne sistemin e kanalizimeve te zones. Ndersa fraksioni i ngurte i dekantimit qe del nga pastrami i pusetave largohet ne vendin e vaktuar nga Bashkia e Shijakut

### **Emetimet ne ajer**

Emetime te vazhdueshme ne ajer nga ky instalim nuk ka. Instalimi nuk ka oxhake, nuk ka fura, nuk perdor lende djegese etj. Emetime ne ajer per periudha te shkurtera ka ne formen e pluhurit, te aromave dhe te CO<sub>2</sub> nga djegja e karburantit

### **Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga automjetet dhe nga transportuesit e mjeteve. Keto zhurma jane vetem brenda ambjenteve te jashteme ku zhvillohet aktiviteti. Nga ky aktivitet nuk prodhohen zhurma me nivel te larte. Ato variojne nga 65-70dBA



ç. Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;

### Ndikimet e pritshme ne mjedis

Ndikimet e mundshme gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permbliohen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

### Ndikime te mundeshme negative ne toke

Levizja e automjeteve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndotje e tokes si rezultat i rjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve</li> </ul>
-----------------------	--

### Ndikimet e mundeshme negative ne uje

Instalimi i prodhimit te ilaçeve dhe suplementeve	<p>Shkarkimet e ujrave vine nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pastrimi i ambientit te punes</li> <li>• Pastrimi i ambienteve nga papastertite e krijuara nga manovrimet e makinave</li> <li>• Derdhja aksidentale e lubrifikanteve dhe lengjeve te tjera</li> <li>• Pastrimi i ambienteve te magazinimit te lrndeve te para</li> </ul>
Levizja e automjeteve te transportit	Si pasoje e manovrimet te automjeteve mund te kemi rrjedhje aksidentale te lubrifikanteve. Ndotja e ujrave mund te vije nga ujrat e larjes
Parkimi i mjeteve	Rjedhje karburanti, lubrifikantesh dhe lengjes mund te kete gjate parkimit te automjeteve. Ndotja e ujrave mund te vije nga ujrat e larjes te vendeve te parkimit

### Ndikime te mundeshme ne biodiversitet/pejsazh.

Instalimi i prodhimit te ilaçeve dhe suplementeve	<p>Aktualisht instalimi i prodhimit te ilaçeve dhe suplementeve eshte e ndertuar dhe ka ndikuar ne ndryshimin e peisazhit dhe ne biodiversitet.</p> <p>Per zbutjen e ketij ndikimi rekomandojme mbjelljen e disa pemeve ne perimetrin e ambienteve te jashteme te LIFEMED</p>
---	---

### Ndikime te mundeshme negative ne ajer

Lëvizja e automjeteve të transportit	<p>Si pasojë e lëvizjes së automjeteve do të gjenerohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhurma,</li> </ul>
--------------------------------------	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• pluhur,</li> <li>• gaze nga djegia e karburantit të motorëve.</li> </ul>
--	---

### Emetimet e zhurmave dhe gazeve të makinave në mjedis

Sa lidhet me emetimin e zhurmave gjatë fazës ndërtimore, duhet theksuar se ky ndikim është i tejkaluar.

Emetime zhurmash do të kemi gjatë procesit të ngarkim shkarkimit. Në këto kuader, i rëndësishëm është ndikimi i zhurmave në qendrat me të afërta të banuara. Siç e kemi shpjeguar, qendra me të afërt të banuar është mbi 100 m, prandaj dhe ndikimi negativ është i paperfillshëm. Megjithatë, pronari duhet të ketë parasysh që niveli i zhurmave të mos i kalojë vlerat kufi të përcaktuara në Udhezimin nr 8, datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara",

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LAeq (dBA)	Koha bazë (orë)	LAmx Fast (dB)
<b>Zona banimi</b>				
Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashtë)	45	8	-
<b>Zona me aktivitetet social-ekonomik</b>				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
<b>Mjedisi urban</b>				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110

Për këtë arsye, është e nevojshme që subjekti të punojë me efikasitet për të mënjanuar orët e tezgjatura të punës duke mënjanuar punimet në orët e para të mëngjesit ose në mbrëmje.

I njëjti arsyetim vlen edhe për sasinë e gazeve, aromave dhe pluhurave që do të emetohen si pasojë e djegies së karburantit në motorë dhe lëvizja e automjeteve.

### **Mbetjet e prodhuara**

Nga instalimi prodhohen mbetje kartoni, letre, qelqi etj. Ky aktivitet konsiderohet si aktivitet që prodhon mbetje të ngurta jo të rrezikshme.

Për deportimin e mbetjeve subjekti ka kontratë shërbimi me sektorin e shërbimeve të Bashkisë Shijak;

#### **d. Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara**

Në kushte normale, ndikimi i këtij aktiviteti në mjedis do të zgjasë për aq kohë sa ky aktivitet të jetë funksional.

#### **dh. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të**

Në kushte normale, ndikimet në mjedis të sipërpermendura, mund të përhapen në distanca fare të vogla. Vetëm ndikimi i zhurmave mund të ndikojë në distanca më të largëta, deri në 100 m. Megjithatë, subjekti duhet të zbatojë me rigorozitet kushtet teknike të punës.

#### **e. mundësia e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësia e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin**

Subjekti duhet të kujdeset për një mjedis të pastër, të rregullt, të sigurtë dhe të paisur me sinjalistikën dhe posterat sensibilizues për kushtet teknike dhe për mjedisin.

Në rast të mbylljes së aktivitetit, mund të merret në konsideratë mundësia e ndryshimit të destinacionit të godinës dhe përmirësimit të odisazhit.

Për këtë subjekti duhet të hartojë një plan mbylljeje të aktivitetit.

Destinacioni i sipërfaqes së tokës ku është ngritur godina e LIFEMED do të varet shumë nga plani i zhvillimit të zonës.

Aktualisht zona ka destinacion per objekte industrial dhe sherbimi. Ne kete kuptim kjo siperfaqe do te zhvillohet per keto aktivitete, qe do te thote qe subjekti ose do te ndryshoje aktivitet brenda kesaj godine, ose do te ngreje nje aktivitet te ri duke prishur objektin ekzistues dhe ndertuar nje te ri.

Ne te dyja rastet, subjekti duhet te plotesoje kerkesat e legjislacionit shqiptar per mjedisin.

#### **ë. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis**

Me qellim minimizimin ne maksimum te efekteve negative mjedisore, qofte edhe potenciale, dhe rritjes se efekteve pozitive ne mjedis, pronari "LIFEMED duhet te mare masa si me poshte.

#### **Per ruajtjen nga ndotjet siperfaqesore dhe te ujrave nentokesore.**

Te survejone regullisht funksionimin e rrjetit te kanalizimeve te ujrave te bardha e te zeza. Ti pastroje regullisht ato.

Te kryej dezinfektimin periodik te tyre.

Te mbaje te paster dhe te sistemuar ambientet e jashteme te objektit

Te mbjelle peme dhe te rise siperfaqen e ambiente te gjelberta ne teritorin e objektit

Te zbatoje procedurat teknike te prodhimit dhe magazinimit, duke evituar ndotjen e sistemit te kanalizimeve te ujrave dhe zjaret

#### **Per trajtimin e mbetjeve te ngurta.**

Te seleksionioje mbetjet e ngurta sipas lloit te materjalit perpara largimit te tyre ne vend depozitim.

Ti depozitonte ato ne vendin e caktuar nga njesia administrative

Te shmange mbajtjen per nje kohe te gjate te mbetjeve ne ambientet e LIFEMED

#### **Per minimizimin e zhurmave.**

Te reklamoje me mjete figurative (tabela, shtypshkrime etj) ndalimin e burive per makinat e klienteve.

Te minimizoj gjenerimin e zhurmave nepermjet perdorimit te paisjeve profesionale

Te paise punetoret me mjete qe ulin efektin e zhurmave si kufje, tapa etj,

#### **Per rruajtjen e ajrit nga ndotjet**

Prodhimi te behet vetem ne ambjente te mbyllura

Te mbaje ne kondicion teknik frigoriferet dhe gjeneratorin.

Te mbaje nen kontroll levizjen e automjeteve

Te percaktoje masat e emergjencave në rastet e aksidenteve industriale për zvogëlimin e ndikimeve në mjedis dhe në cilësinë e tij

Te mirëmbaje sipërfaqet rrugore për të pakësuar sa më shumë që të jetë e mundur ringritjen e pezullive.

### **Per eliminimin e rasteve aksidentale si zjare e tymra.**

Te instruktoje punonjesit per masat e mbrojtjes nga zjarri,

Te reklamoje kuadrin ligjor per mbrojtjen nga zjari, ndalimin e pirjes se duhanit e tj.

Te nderojte ne menyre periodike fiksate e zjarit simbas afateve te skadimit

Te mbaje te rezervuar nje sasi rreth 1 m<sup>3</sup> rere te shkrifet per nderhyrje emergjente

### **Per regullat e sigurimit teknik**

Te reklamoje ne vende te dukshme rregulloret e sigurimit teknik,

Te kryej ne menyre periodike instruktimin e punonjesve sipas afateve te percaktuara ne legjislacionin shqiptar etj.

Te percaktoje kriteret dhe politikat për futjen e teknologjive bashkëkohore

### **Per percaktimin e regullave ne rastet e ndikimit te faktorevet klimatike**

Përcaktimi i protokolleve dhe monitorimi i rasteve të trajtimit të ndotjeve që vijnë si pasojë e ngjarjeve të motit;

Përcaktimi i masave të emergjencave civile për të shmangur/zbutur ndikimet nga kushtet ekstreme të motit;


Te hartojte planin e emergjencave

Per “Green Hours” shpk

Administratori

Dr. Bardhyl Qilimi

Tirane me 26.10.2019



Eksperti

Denis Harasani

A handwritten signature in blue ink, which appears to read 'Harasani', is written over the name 'Denis Harasani'.